

KOMUNA E HANIT TË ELEZIT 2017: PROBLEMET KRYESORE DHE TRENDET BUXHETORE

Hyrje

Komuna e Hanit të Elezit është krijuar në vitin 2005 si pilot njësi komunale për t'u shndërruar në komunë me kompetenca të plota që nga janari i vitit 2010. Është e vetmja komunë në Kosovë e cila qeveriset nga një kandidat i pavarur. Kryetar i Komunës është Refki Suma. Ky është mandati i dytë i tij.

Në zgjedhjet e kaluara komunale, kandidatët për kryetarë kanë dhënë premtime të cilat nuk bien nën kompetencat vetanake të komunave. Megjithatë, hulumtimet tregojnë se qytetarët e Kosovës kanë njohuri të mjaftueshme mbi ndarjen e kompetencave në mes të pushtetit qendror dhe lokal.¹ Sipas hulumtimit të UNDP-së, 86% e qytetarëve besojnë që të gjitha apo disa probleme me të cilat ballafaqohen komuna e tyre, mund të zgjidhen nga pushteti lokal. Ndërsa sa i përket shkallës së kënaqshmërisë së qytetareve të Hanit të Elezit me pushtetin lokal (Kryetarin, Kuvendin Komunal dhe Administratën Komunale) del se ka pasuar rënie. Kënaqshmëria me pushtetin lokal në Komunën e Hanit të Elezit në vitin 2015 ishte 71,02% në krahasim me vitin 2012 që ka qenë 86,9%.²

Të gjeturat e hulumtimit nga Instituti GAP në vitin 2013 për problemet kryesore që i ka Komuna e Hanit të Elezit kanë qenë mungesa e ujit të pijes, menaxhimi i mbeturinave, ndotja e lumit Lepenc, ndotja e ajrit nga fabrika "Sharr Cem", mungesa e çerdheve, mungesa e stacionit të autobusëve dhe parkingjeve, mungesa e stafit mjekësor, si dhe mosmirëmbajtja e ndërtesave të vjetra.

¹ Instituti GAP, Raporti hulumtues, Adresimi i Përgjegjësisë, Njohuritë e Qytetarëve me Kompetencat e Komunave 2016, Burimi: http://www.institutigap.org/documents/36032_Raporti%20adresimi%20i%20pergjegjesise.pdf

² <http://asemblio.github.io/kosovo-mosaic-visualizer/sq/index.html>

Problemet aktuale të Komunës së Hanit të Elezit

Mungesa e ujit të pijes.

Ky problem vazhdon të jetë edhe në vitin 2016, Hani i Elezit e ka pasur të instaluar sistemin e ujësjellësit që nga vitet '80, i cili në atë kohë është instaluar për nevojat e fabrikës "Sharr-Cem". Edhe pas luftës ka pasur investime të reja në sistemin e ri të ujësjellësit, mirëpo problemi akoma nuk është i zgjidhur pasi që qytetarët ankohen për mungesë të ujit të pijes dhe reduktimeve të shpeshta. Ndërsa, shumica e fshatrave janë të organizuara me sisteme të ujësjellësit individual përmes puseve. Përveç kësaj, brengë më e madhe për qytetarët është edhe cilësia jo e mirë e ujit.

Ndotja e lumit "Lepenc".

Ky lum i cili kalon nëpër Han të Elezit është i ndotur, ku përpos ndotjes nga derdhja e kanalizimeve dhe mbeturinave në të, lumi ndotet edhe nga hedhjet e kemikaleve si pasojë e ekzistencës së industrisë së rëndë në këtë komunë.

Ndotja e ajrit.

Me gjithë përmirësimet në teknologjinë e fabrikës së çimentos "Sharr Cem," akoma është evidente ndotja e ambientit në Han të Elezit. Gjatë vitit 2012, Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Kaçanik, pati paditur "Sharr Cem"-in për ndotje të mjedisit, procedurë kjo e iniciuar nga inspektorati i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Qytetarët janë të brengosur edhe me mbetjen e mbeturinave nga prodhimet azbest çimentos të cilat mund të hasen përgjatë shtratit të lumit "Lepenc". Gjithashtu si problem tjetër e cila është duke e ndotur ajrin në këtë komunë janë gurëthyesit që punojnë në këtë regjion. Banorët e këtyre komunave ankohen se veprimtaria e këtyre kompanive po u shkakton shqetësime të mëdha mjedisore, pasi ato nuk po ndërmarrin masat e duhura për t'i mbrojtur ata nga ndotja.

Mungesa e çerdheve, stacionit të autobusëve dhe parkingjeve.

Janë këto tri kategori të ndryshme për të cilat qytetarët kanë shprehur shqetësimin e tyre. Edhe pse ndërtimi i çerdhes publike dhe stacionit të autobusëve janë paraparë në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2014-2016, si dhe në buxhetin e vitit 2016 por ende ndërtimet nuk janë bërë. Ndërsa mungesa e parkingjeve në qytet mbetet akoma problem i cili duhet të zgjidhet.

Mungesa e stafit mjekësor.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Han të Elezit punon me tri ndërrime në 24 orë, mirëpo ka mungesë të stafit mjekësor sidomos në emergjencë, pediatri, gjinekologji dhe stomatologji.

Fushat që kërkojnë vëmendjen e komunës

Hapja e një reparti të stomatologjisë

Komuna e Hanit të Elezit akoma nuk ka një repart të stomatologjisë. Banoret detyrohen për këtë shërbim të udhëtojnë deri në Kaçanik e shpesh herë edhe deri në Ferizaj. Komuna do të duhej ta shoh mundësinë përmes ndonjë donacioni ose nga buxheti i saj të hap një repart të tillë.

Zhvillimi i aktiviteteve kulturore dhe sportive

Në komunë të Hanit të Elezit janë të ralla aktivitetet kulturore dhe sportive. Komuna do të duhej që në katër vitet e ardhshme të shoh mundësinë e shpeshimit të këtyre aktiviteteve që do të ndikonin pozitivisht në promovimin e komunës por edhe në aktivizimin e rinisë së kësaj ane.

Trendet buxhetore në Komunën e Hanit të Elezit (2017)

Komuna e Hanit të Elezit në vitin 2017 ka planifikuar 2.4 milion euro buxhet.³ Në këtë buxhet do të barten nga viti 2016 edhe 86 mijë euro të tjera nga të hyrat vetanake të pashpenzuara.⁴ Krahasuar me buxhetin e planifikuar të vitit 2013*⁵, që ishte vit i zgjedhjeve lokale, buxheti i Komunës së Hanit të Elezit ka pasur një rritje prej rreth 600 mijë eurove. Kjo rritje në masë të madhe buron nga rritja e granteve qeveritare.


³ Shih për më shumë platformën buxhetore të Institutit GAP në <http://bit.ly/2gNH8CE> dhe Ligjin Nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.

⁴ Ministria e Financave. Raporti Financiar 2016. Burimi: <http://bit.ly/2eFtgKj>, faqe 63 (hapur më 6 shtator 2017).

* Në këtë vit mjetet e bartura nga të hyrat e pashpenzuara ishin më të vogla se në 2017 për rreth 20 mijë euro. Shih Raportin vjetor financiar 2012. Ministria e Financave. Burimi: <http://bit.ly/2wKArJf>, faqe 60 (hapur më 6 shtator 2017).

⁵ Shih Ligjin Nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013.

Figura nr.1: Buxheti i Komunës së Hanit të Elezit 2017




Në buxhetin e vitit 2017 janë ndarë rreth 300 mijë euro më shumë për kategorinë e pagave dhe mëditjeve (1.4 milionë euro) se në 2013 dhe janë rritur po ashtu shpenzimet kapitale (737 mijë euro) për mbi 200 mijë euro. Kurse, në kategoritë tjera ndryshimet ishin shumë të vogla. Ndikim të madh në rritjen e buxhetit për paga kishte vendimi i Qeverisë së Kosovës i vitit 2014 për rritjen e pagave në sektorin publik për 25%.⁶ Gjithashtu, angazhimi i 22 punonjësve të rinj⁷ në periudhën 2013-2016 ka bërë që shpenzimet për paga të rrisin pjesëmarrjen e tyre në buxhetin vjetor të komunës.

⁶ Zyra e Kryeministrit, Vendimet e mbledhjes së 172-të të qeverisë. Burimi: <http://bit.ly/2w6MK0M> (hapur më 6 shtator 2017).


⁷ Ministria e Financave. Raporti Financiar 2016. Burimi: <http://bit.ly/2eFtgKj> (hapur më 6 shtator 2017).

Figura nr.2: Trendet buxhetore të Hanit të Elezit më 2013 dhe 2017



Të hyrat vetanake të Komunës së Hanit të Elezit kanë pasur ngritje dhe rënie të lehta përgjatë katër viteve të fundit, me një rritje më të theksuar në 2016. Gjatë vitit 2016, Hani i Elezit ka pasur 251 mijë euro të hyrash komunale⁸, ku mbi 41% e tyre janë arkëtuar nga kategoria e tatimit në pronë. Kategoritë tjera të mëdha, si ajo e të hyrave nga veprimtaritë afariste, thuhet nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim nga viti 2015.⁹

Figura nr.3: Të hyrat komunale të Hanit të Elezit, 2013-2016



Burimi: Zyra e Auditorit të përgjithshëm

⁸ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti për Komunën e Hanit të Elezit 2016. Burimi: <http://bit.ly/2gPUVwp> (hapur më 6 shtator 2017).

⁹ Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve të realizuara buxhetore për periudhën janar – dhjetor 2016 për Komunën e Hanit të Elezit.

Sipas vlerësimeve buxhetore të prezantuara në ligjin për buxhetin 2017¹⁰, buxheti i Hanit të Elezit do të ketë rënie më 2018 dhe 2019. Krahasuar më 2017, në këto dy vite të ardhshme buxheti planifikohet të jetë rreth 10 për qind (2.1 milionë euro) dhe 9 për qind (2.2 milionë euro) më i vogël, respektivisht. Ulje më të theksuar pritet të ketë në kategorinë e planifikimit urban dhe mjedisit, specifikisht rreth 45% më pak në 2018 dhe 30% më pak më 2019.

Rekomandime

Duke u bazuar në problemet kryesore, fushat të cilat kërkojnë vëmendjen e Komunës dhe trendet buxhetore, Instituti GAP rekomandon që qeverisja e komunës e dalë nga zgjedhjet lokale të 2017 të ndërmerr këto veprime:

- Komuna e Hanit të Elezit duhet të hapë repartin e stomatologjisë.
- Komuna e Hanit të Elezit duhet t'i kushtojë më shumë vëmendje dhe t'i fokusojë një pjesë të investimeve në zhvillimin e sportit dhe kulturës.
- Komuna e Hanit të Elezit duhet të shohë mundësinë e ndërtimit të ndonjë muzeu, shtëpie të kulturës dhe bibliotekës së qytetit.
- Komuna e Hanit të Elezit duhet të heqë dorë nga pritja e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për të pastruar lumin Lepenc. Komuna duhet të nis me mundësitë e saj pastrimin e këtij lumi.
- Komuna e Hanit të Elezit duhet të nisë me ndërtimin e çerdhes së parë në këtë komunë.

¹⁰ Ligji Nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, faqe 312.

Instituti për Studime të Avancuara GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Ky projekt mbështetet nga:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world

